



Misioni ynë

Revistë informative, kulturore dhe shpirtërore, viti II, nr.7, korrik-shtator 2022

(Mos) Rënia në dëshpërim Të parët tanë dhe dëshpërimi

Faqe 20-21

Luzern, mars 2022

THIRRJE PËR DONACION

Të dashur vëllezër dhe motra!

Misioni Katolik Shqiptar në Luzern në këtë vit, më 22 dhe 23 tetor, do të kremtojë 30-të vjetorin e themelimit. Misioni tash tridhjetë vite me përkushtim të plotë vazhdon të punojë për të mirën shpirtërore, kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve katolikë që jetojnë dhe veprojnë në Zvicër. Misioni ynë këto vlera i kultivon dhe ndan njëkohësisht me të gjithë shqiptarët e përkatësisë fetare islame apo edhe ortodokse.

Që festa jonë të jetë më e përgatitur dhe më madhështore, jemi të varur nga ndihma dhe kontributi Juaj. Prandaj, për të kuptuar më saktë qëllimin e donacionit Tuaj, Ju lutemi ta shënoni fjalën kyçe „Jubileu i Misionit“.


Duke Ju falënderuar qysh tash për mbështetjen Tuaj, njëkohësisht Ju ftojme të përgatiteni shpirtërisht për pjesëmarrje në këtë manifestim të rëndësishëm.

Zoja e Këshillit të Mirë, pajtorja e Misionit dhe e popullit tonë shqiptar, ndërmjetësoftë për ne dhe familjet tona

Jon Anton Uka

Don Anton Uka

Përgjegjës i Misionit



Konto:
CH24 0077 8155 5749 1200 3
Albaner Mission
Rodteggstrasse 6
6005 Luzern

Masa ndëshkuese dhe njeriu

Sot jetojmë në një kohë të përshpejtuar dhe të ndryshimeve të shpejta ku masa e madhe e popullit në vrapim të vazhdueshëm (kërkim), sikur e ka përjashtuar personin dhe kërkesat (nevojat) e tija të brendshme.

Në librin Etika e komunikimit, që para pak muajve është publikuar në Shqipëri, sjell disa episode biblike për të ripohuar se në qendër të misionit apo të veprimtarisë kishtarë dhe asaj laike duhet të jetë gjithmonë njeriu në tërësinë e tij, pa paragjykimë. Në këtë vepër theksohet se masa nuk mund ta zhdukë praninë e personit dhe aq më pak dëshirat e tij më të thella për afirmim, për drejtësi dhe për liri; nuk mund t'i zhdukë nevojat e tij fizike për shërim, as ato psikologjike për pranim dhe dashuri, e aq më pak ato shpirtërore për falje dhe për shpëtim. Aftësia e Jezusit për të parë, në mes të turmës, integritetin e personit dhe të dëshirave të tij është unike dhe befasuese.

Vëmendja dhe dhembshuria e Jezusit për personin, personin e zhytur dhe për disa aspekte, madje “të humbur” në turmën e madhe apo në kaosin e madh, është e dukshme në episodin e Zakeut: “Jezusi erdhi në atë vend, shikoi lart dhe i tha: “Zake, zbrit shpejt! Sot do të vij të rri në shtëpinë tënde!”. Ai zbriti me nxitim dhe e pranoi plot gëzim” (Lk 19, 5-6).

Tregimi i Shën Gjonit për gruan kurorëthyesë, në të cilën turma e turbulluar dhe e pashpirt ndaj mëkateses së zënë në faj, kërkon dënimin kapital me gjuajtjen me gurë, Jezusi u përgjigjet: “Kush është prej jush pa mëkat, le ta gjuajë i pari gurin në të”. Tregimi vazhdon: “ata nisën një nga një të largohen duke filluar prej më të vjetërve. Jezusi mbeti vetëm – dhe gruaja që po qëndronte në këmbë në mes”. Kur turma zhduket dhe mbetet vetëm gruaja, Jezusi e lë shkrimin e vet enigmatik mbi rërë dhe bën me të një dialog shumë personal: “Grua, ku janë ata? Askush nuk të dënoi?” “Askush, Zotëri”. “As unë nuk po të dënoj: shko, por tani e tutje mos mëkato më” (krh. Gjn 8, 7-11).

Edhe në episodin e Bartimeut, i verbër dhe lypsar, shohim Jezusin që kupton kërkesën e personit, ndien zërin e tij dhe dëgjon lutjen e tij: “Shumëkush e qortonte të heshtte, porse ai bërtiste edhe më fort: “Biri i Davidit, ki mëshirë për mua!”. Jezusi zuri vend e tha: “Thirreni!”. Ata i bënë zë të verbrit dhe i thanë: “Mos u tremb! Çohu se po të thërret!”. I verbëri hodhi mantelin e vet, menjëherë u ngrit dhe shkoi te Jezusi. Jezusi e pyeti: “Çka dëshiron të bëj për ty?”. “Rabbuni! Që të shoh!” u përgjigj i verbëri. Jezusi i tha: “Shko lirisht! Feja jote të shpëtoi!”. Dhe aty për aty pa e u vu të udhëtojë pas Jezusit” (Mk 10, 48-52).

Tani që po kremtojmë 30-të vjetorin e themelimit të Misionit tonë në Luzern, uroj dhe thërras që personi, pra secili njeri, ashtu siç ishte për Jezusin, të jetë edhe për ne në qendër të punës, të shërbimit dhe të lutjes tonë të përditshme, të vetëdijshëm se përbrenda çdo personi qëndron një histori, një vuajtje, një kërkesë dhe një dëshirë për shpëtim dhe shëlbim (shenjtërim). Në njeriun jemi të ftuar ta takojmë Hyjin dhe ta shërbejmë atë.



FESTA ME KORIN NË WILLISAU

(Foto: don Anton Uka)

Misioni ynë ka nëntë qendra në të cilat kremtohet rregullisht Mesha e shenjtë. Në disa prej tyre zhvillohen edhe aktivitete të tjera, si p.sh., katekizmi për fëmijët dhe provat e këngëve kishtarë me anëtarët e korit.

Willisau është njëra ndër qendrat ku një grup i antarëve të korit takohemi rregullisht dhe bëjmë provat apo ushtrimet e këngëve.

Me 23 qershor, natën e festës së Zembrës Krishtit, në ambientet e bukura të qendrës tonë kishtarë në Willisau kemi organizuar një mbrëmje dhe një darkë të përbashkët. Ushqimet e shumta dhe të shijshme tradicionale shqiptare, të përgatitura nga vet besimtarët e bënë këtë mbrëmje vërtetë të veçantë. Por,

pjesa më e bukur e të qenurit bashkë apo takimeve tona janë bisedat vëllazërore, shakatë, humori, kënga dhe bashkëndarja vëllazërore e ushqimeve dhe e shërbimeve.

Gjatë kësaj feste, don Antoni, në emër edhe të motrave, m. Vida dhe të m. Mrika, përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit, duke theksuar rëndësinë e takimeve të tilla. Ai, po ashtu, veçoi se vlera e kontributit që anëtarët e korit japin me praninë, këndimin dhe shembullin e tyre është vërtetë e madhe dhe e pazëvendësueshme brenda bashkësisë së Misionit tonë. Një gjë tjetër që theksoi ai, ishte edhe organizimi dhe mobilizimi sa më i mirë për kremtimin e 30-të vjetorit të themelimit të Misionit, që do të shënohet me 22 dhe 23 tetor të këtij viti.

Nga anëtarët e korit e mori fjalën Franqez Kaqinari i cili pohoi se takimet e tilla është mirë të jenë më të shpeshta, sepse janë një mundësi e mirë edhe për tu takuar dhe shoqëruar e njëri-tjetrin. Ai po ashtu falënderoi gjithë të pranishmit për zellin dhe përkushtimin, në mënyrë të veçantë meshtarin dhe motrat e nderit.

Me një lutje të përbashkët drejtuar Hyjit, kërkua që zemrat tona dhe të besimtarëve të Misionit tonë, t'i përngajnë Zembrës tejet të shenjtë të Jezu Krishtit.



(Foto: Gjoana Tuqi)

Shkruan: Redaksia



BASHKËSI E THEMELUAR NË DASHURI

(Foto: don Anton Uka)

Misioni ynë vepron sipas një agjende të pasur me aktivitete të shumta shpirtërore, kulturore dhe argëtuese. E bukura e Bashkësisë tonë janë njerëzit apo besimtarët që e përbëjnë atë. Kjo bëhet edhe më e bukur kur secili, në mundësinë dhe aftësinë e vet, mundohet të japë kontributin personal apo familjar në propozimet e shumta që ne ofrojmë me qëllim të një formimi të mirë dhe të vazhdueshëm shpirtëror, kulturor dhe miqësor.

Të shtunën, me 25 qershor, të gjitha grupet që angazhohen në Misionin tonë në Luzern, pra

Ministrantët, Kori i fëmijëve dhe i të rriturve, Këshilltarët, Lexuesit, Ndarësit e Kungimit, Forumi i Grave, Redaksia e Revistës etj., ishin të ftuar në shëtitjen tonë të përbashkët. Kjo ishte vërtetë një mundësi e mirë për të qëndruar me njëri-tjetrin, për ta falënderuar Zotin dhe për tu kënaqur me argëtime të shumta dhe ushqime të shijshme.

Koha e bukur dhe aktivitetet e shumta dhe interesante që u zhvilluan në këtë ditë, e bënë të veçantë përvojën tonë.

Shkruan: Redaksia



(Foto: don Anton Uka)



(Foto: Gjergj Prenrecaj)



(Foto: Radio Maria Kosovë)

Me 26 qershor, në Misionin tonë ishte i pranishëm stafi i Radio Marisë nga Kosova. Këtë të diele Meshën e shenjtë në Emmenbrücke dhe në Menznau i kremtoi drejtori i Radio Marisë, don Shtjefen Dodës, në bashkëmëshim me don Antonin. Të dyja këto Meshë u transmetuan drejtpërdrejtë në Radio Mari.

Don Shtjefni, në predikimin e rastit përveçse shpjegoi porosinë e Ungjillit të asaj dite, ai po ashtu foli edhe për misionin që Radio Maria ka në shpalljen e Lajmit të Gëzueshëm, prandaj edhe është e rëndësishme të promovohet dhe të ndihmohet financiarisht kjo vepër apo ky mjet ungjillëzimi. Përmes Radio Marisë dëgjuesit kanë mundësi rregullisht ta dëgjojnë Fjalën e Zotit, të luten së bashku me besimtarët e tjerë, të marrin njohuri të ndryshme mbi Kishën në botë dhe atë në vendlindje.



(Foto: Radio Maria Kosovë)



(Foto: Radio Maria Kosovë)

Don Shtjefni me këtë rast ka falënderuar besimtarët dhe

dëgjuesit e Radio Marisë së Kosovës për ndihmën që japin në mënyrë që kjo Radio e Kishës Katolike të mund të vazhdojë misionin e vet, në mënyrë të veçantë ndaj të vetmuarve dhe të sëmurëve.

Në përfundim të Meshës don Antoni falënderoi stafin e Radio Marisë për praninë e tyre në mesin tonë dhe njëkohësisht i ftoi besimtarët që të kontribuojnë me mjete financiare.

Besimtarët tanë sa herë që kërkohet ndihmë për dikë apo për diçka, gjithmonë, dëshmojnë se kanë një zemër të madhe dhe shumë bujare, kjo u dëshmuar edhe nga shuma e 2500.-frangave që Misioni ynë atë ditë i dhuroi Radio Marisë.

Urojmë dhe porosisim besimtarët tanë që edhe në të ardhmen të vazhdojnë ta ndihmojnë Radio Marinë.

Shkruan: Redaksia



(Foto: Radio Maria Kosovë)



DARKË PUNE ME FORUMIN E GRAVE

(Foto: nga Arkivi)

Me 6 korrik Misioni ynë ka shtruar një darkë pune për stafin e ngushtë të Forumit të Grave. Në këtë darkë, përveç falënderimit për punën e vyer dhe të shkëlqyer që bëjnë zonjat e Forumit të Grave të Misionit tonë, po ashtu patëm mundësi edhe të bisedojmë mbi tema të rëndësishme të jetës tonë shpirtërore, organizative dhe kulturore. Kryesisht u bisedua mbi koordinimin dhe harmonizimin e aktiviteteve në një agjendë të vetme vjetore, por shqyrtuam edhe mundësinë e zgjerimit të Forumit të Grave dhe përfshirjen e tij në të gjitha vendet ku banojnë besimtarët e Misionit tonë. Bashkëpunimi mes njëra-tjetrës dhe hapja e bashkëpunimit me Forumet e tjera ekzistuese në Zvicër, ishte një temë

tjetër të cilën e vlerësuam me shumë kujdes. Theksi i veçantë i vu edhe mbi mundësinë e takimeve më të shpeshta shpirtërore dhe kulturore.

Në këtë takim është vënë re edhe vullneti i mirë dhe gatishmëria e grave, dëshira për të bërë gjëra të mira, për të ndihmuar nevojtarët, për të ecur puna sa ma mirë në Misionin tonë pa u kursyer as pak as me ndihmën financiare, as me punën dhe kushtimin e kohës së tyre për Misionin tonë.

Falënderojmë Zotin për gjithçka që bën nëpërmjet nesh dhe të gjitha gratë për bashkëpunim dhe punën e çmuar të tyre.

Shkruan: Redaksia



(Foto: m. Mrika Sabedini)



(Foto: Nue Tuqi)

FILLIMI I VITIT TË RI SHKOLLOR

Të dielën, me 21 gusht, Mesha e shenjtë është kremtuar në Goldau dhe në Sursee. Pasi të nesërmen fëmijët e kantonit të Luzernit fillonin vitin e ri shkollor 2022/2023, don Antoni bëri bekimin e fëmijëve dhe të mje-teve të tyre shkollore.

Fëmijët e ardhur së bashku me prindërit e tyre, ishin të shumtë, sidomos në Sursee dhe në Emmenbrücke. Gjatë këtyre Meshëve lutem Zotin që bekimi i Tij mos t'ju mungojë kurrë fëmijëve të Misionit tonë dhe të gjithë fëmijëve

në të gjithë botën, në veçanti atyre që gjenden në rreziqe lufte dhe në çdo rrezik tjetër. Urimi dhe bekimi ishte që të gjithë fëmijët e Misionit tonë t'i përcjellë bekimi dhe mbrojtja e Hyjit në të gjitha situatat e jetës së tyre, që të mund të rriten në hirin e Zotit.

Në fytyrat e fëmijëve vërehej gëzimi dhe lum-turia, por edhe gëzimi për fillimin e vitit të ri shkollor.

Shkruan: Redaksia



(Foto: Nue Tuqi)



(Foto: Nue Tuqi)



SHËTITJA ME LANDESKIRCHE

(Foto: nga Arkivi)

Më 30 gusht Landeskriche në Luzern organizoi shëtitje me të gjitha misionet e gjuhëve të huaja të pranishme në kantonin e Luzernit. Takimi i përbashkët për një pjesë të pjesëmarrësve ishte në ora 13:30 në Abendweg, tek selia e Landeskriche, kurse të tjerët ishin bashkuar tek qendra italiane Papa Govanni në Emmenbrücke.

Në këtë shëtitje morën pjesë: Misioni shqiptar, kroat, italian, polak, spanjoll dhe ai i gjuhës angleze. Së bashku me të gjithë pjesëmarrësit e misioneve të ndryshme ishin edhe katër përfaqësues të Landeskriche. Fillimisht udhëtuan drejt Sempach-ut, dhe atje kemi vizituar kopshtin Vogelfwarte. Ishte kënaqësi të shohësh zogj të vendosur në mënyrë të përsosur në foletë ose në mënyrën e jetës së tyre.



(Foto: don Anton Uka)

Më pas kemi vazhduar për në Sursee, ku kemi vizituar qendrën e re dhe të rinovuar të Kishës aty. Zotëri Hans Peter Bucher na ka shpjeguar projektin dhe aktivitetet që mund të bëheshin në atë qendër por na dha edhe lajmin e mirë hapjen e re të faqes së internetit: www.migrantenseelsorge-luzern.ch/ ku do të jenë të paraqitura të gjitha aktivitetet e misioneve të ndryshme. Me këtë rast u tha se do të ketë edhe qendër për misionarin ukrainas dhe sllovak dhe më pas ishte një apero i pasur për të gjithë.

Prej Sursee kemi vazhduar në Kaltbach, ku kemi vizituar fabrikën e prodhimit të djathit. Një drejtues i asaj fabrike na ka shpjeguar dhe treguar vendin që ishte në formë tunelesh ku ruhet, apo thahet djathi, historikun e shkurtër deri tek arritja e prodhimit në ditët e sotme dhe në fund ishte darka e përbashkët për të gjithë pjesëmarrësit.



(Foto: don Anton Uka)

Falënderojmë Zotin për të gjitha të mirat dhe befasishtë që na ofron gjatë gjithë jetës sonë dhe faleminderit edhe organizatorëve të kësaj shëtitje.

Shkruan: m. Vida Ademi



(Foto: Nue Tuqij)

Me 5 shtator kalendari kishtar liturgjikisht përkujton Shën Nënë Terezën e Kalkutës, të bijën më të dashur të popullit tonë. Në Misionin tonë, tashmë po bëhet traditë, përgatitja shpirtërore për kremtimin e festës së Nënë Terezës. Sikurse vitin e kaluar edhe këtë vit filluam me treditëshin përgatitor që u mbajt në kishën e qendrës së Misionit tonë në Luzern. Ky treditësh ju propozohet besimtarëve si një ripërtëritje shpirtërore që duke u bazuar në jetën dhe në lutjet e Nënë Terezës të mund të reflektojnë, të meditojnë dhe të lutën më mirë.

Në ditën e parë të treditëshit, në prani të një numri të mirë të besimtarëve, don Antoni mori si tekst meditimi një lutje të Nënë Terezës e

cila fillimisht flet për vetëdijen bindjes për dashurinë e Jezusit për ne dhe të dashurisë tonë për të. Kjo bindje, sipas mësimit të Nënë Terezës, është porsidrita e diellit që bën të rritet limfa e jetës dhe bën të lulëzojnë gonxhet e shenjtërisë. Kjo bindje është shkëmbi mbi të cilin ndërtohet shenjtëria. Pastaj, don Antoni, duke u bazuar në lutjen e Nënë Terezës, theksoi: “Djali mund të përdorë plagët e jetës, ai nganjëherë i përdor gabimet tona për të bërë që të mendojmë se është e pamundur që Jezusi na do dhe se vërtetë dëshiron të qëndrojë së bashku me ne. Ky është një rrezik për të gjithë ne. Kjo gjë është aq e trishtueshme, sepse është në kundërshtim të plotë me dëshirën e Jezusit, që pret për të thënë: Ai ju do gjithmonë,



(Foto: Kastriot Frokaj)

edhe kur nuk e ndjeni vetën të denjë. Jezusi të do me butësi, ti je i çmueshëm për të. Drejtoju Jezusit me besim të madh dhe lejo që ai të të dojë! E shkuara i përket mëshirës së Tij, e ardhmja provanisë së Tij, e sotmja dashurisë së Tij!”.

Në ditën e dytë të treditëshit tema e medimit ishte, lutja e Nënë Terezës me titull: “Zoti e do botën nëpërmjet nesh”. Edhe në këtë meditim u theksua se edhe ne jemi të dërguar në botë për të qenë misionar të dashurisë. Në shembullin e Nënë Terezës, për të gjithë ata që jetojnë nën ndikimin e urrejtjes dhe të smirës, jemi të thirrur të jemi të thirrur ta dëshmojmë dashurinë e Hyjit. Për të gjithë ata që jetojnë në errësirën e mëkatit, duhet të jemi drita e Hyjit, dhe për ata që jetojnë në trishtim, duhet të jemi ngushëllimi i zemrës së tyre, theksoi don Antoni.

Dita e tretë e treditëshit, meqenëse ishte e diele, në të tri meshët e kremtuara, u përçua mësimi dhe porosia e dashurisë së Nënë Terezës. Në fund të meshës, ashtu siç kishim bërë edhe në ditët e mëparshme kemi lutur litanitë kushtuar Shën Nënë Terezës.

Ndërsa, ditën e festës së Nënë Terezës, në mbrëmje është kremtuar mesha e shenjtë. Ne predikimin e rastit, don Antoni është përqendruar kryesisht në jetën dhe veprën e Nënë Terezës, duke ftuar të pranishmit për ta ndjekur shembullin e saj.

Pas meshe, për të gjithë të pranishmit, ishte

përgatitur një mbrëmje e përbashkët, ku të gjithë patën mundësi të shërbehen me gjëra të mira ushqimore dhe njëkohësisht të qëndrojnë e të bisedojnë me njëri-tjetrin.

Lirisht mund të themi se ne shqiptarët e kemi fatin që kjo shenjtëreshë kaq e madhe e Kishës, të jetë bij e popullit dhe e Kishës tonë. Për këtë jemi të ftuar që në vazhdimësi ta lusim Shën Nënë Terezën për të gjitha familjet e Misionit tonë, si dhe për nevojat tona shpirtërore dhe trupore.

Shkruan: Redaksia



(Foto: Kastriot Frokaj)



(Foto: don Anton Uka)



Në vazhden e aktiviteteve që organizon Misioni ynë në Luzern, është i paraparë dhe tashmë i realizuar për këtë vit edhe shtegtimi në shenjtëroren e bukur të Bruder Klaus në Flüeli-Ranft.

Shtegtimet vërtetë janë përvoja të bukura dhe shumë të veçanta, që në njëfarë mënyre mund të krahasohen me vet jetën, bukuria e së cilës varet nga dinamizmi, entuziazmi, qëllimi dhe ballafaqimi i situatave me zemër që beson dhe me sy që shikojnë përtej atyre vështirësive (sfidave) që jeta mund të paraqesë në udhëtimin e vet.

Shtegtimet e organizuara dhe të përjetuara në stilin shpirtëror dhe miqësor, pra të karakterizuara nga njeti apo qëllimi, lutja, besimi, përkushtimi dhe bashkëndarja, janë një mundësi e mirë që e ndihmojnë dukshëm formimin personal dhe ko-

lektiv. Këto përvoja e ndihmojnë njeriun duke e nxitur atë që të ecë përpara, e mësojnë të futet në klimën shpirtërore të lutjes dhe meditimit, e formojnë t'i ballafaqojë situatat e vështira të motit, që shumë herë i ngjasojnë motit tonë të brendshëm shpirtëror dhe mendor që shpesh herë ndryshon dhe sikur dëshiron të na bllokojë në ecjen tonë në përditshmëri.

Me këto ndjenja dhe me këtë vetëdije mbi domethënien e shtegimit, një grup besimtarësh nga Misioni ynë, të shtunën, me 10 shtator, në orën 6:00 të mëngjesit u takuam pranë Qendrës tonë, bëmë lutjen e fillimit dhe u nisëm drejt vendit të dëshiruar.

Me të arritur në Flüeli-Ranft kremtuam Mesën e shenjtë dhe menjëherë pas saj kishim drekën e përbashkët dhe shumë vëllazërore të ofruar nga Misioni ynë.

Falënderimi i takon Zotit dhe secilit të pranishëm për përvojën e mirë dhe shumë frytdhënëse që përjetuam gjatë asaj dite.

Shkruan: Valentina Prenrecaj, Root



(Foto: nga Arkivi)



(Foto: nga Arkivi)



FUNDJAVA NË MISIONIN TONË

(Foto: don Anton Uka)

Bashkësia e krishterë, e frymëzuar dhe e nxitur nga Shpirti Shenjt, në mënyrë të natyrshme shndërrohet në një bashkësi ku miqësia, gëzimi, buzëqeshja, argëtimi, kënga dhe falënderimi bëhen pjesë përbërëse e jetës (gjallërisë) së saj. Këtë gjë mundohemi ta mishërojmë në Misionin tonë, veçanërisht në fundjavë, ku mundësia për tu takuar dhe qëndruar së bashku është më e madhe.

Çdo të premte dhe të shtune, në ambientet e qendrës tonë në Luzern, zhvillohen aktivitete të shumta dhe të rëndësishme për jetën e Misionit tonë. Pagëzimi i foshnjave, provat e këngëve me anëtarët e korit të të rriturve dhe fëmijëve, ka-

tekizmi për fëmijët dhe adoleshentët, Qendra e Dëgjimit për ata që kanë nevojë për t'i dëgjuar apo edhe për t'i këshilluar me një fjalë të mirë jete dhe shprese, mundësia për tu argëtuar me lojëra të ndryshme, janë vetëm disa nga mundësitë e shumta që Misioni ynë ofron për të gjithë, pa përjashtim, në çdo fundjavë.

E falënderojmë Zotin dhe secilin person që në mënyrën dhe formën e vet, mundohet që Misionin tonë ta bëjë dhe më tepër bashkësi (familje) ku mbretëron gëzimi, miqësia dhe dashuria vëllazërore.

Shkruan: Redaksia



(Foto: don Anton Uka)



(Foto: don Anton Uka)

INTERVISTË ME ZONJËN AIDA AVGUSTINI

AKTIVISTE E DALLUR E MISIONIT NË LUZERN



Znj. Aida Avgustini së pari dua t'ju falënderoj për bashkëpunimin e gjatë që keni me Misionin Katolik Shqiptar në Luzern!

Falënderimi ju takon juve që më keni përzgjedhur për dhënien e kësaj interviste!

Znj. Aida, a mund të na flisni pak për jetën tuaj në përgjithësi?

Jam lindur në Prizren, në një familje e cila ka qenë e lidhur dhe e kushtuar ndaj kombit dhe fesë. Qysh në fëmijëri kam qenë e lidhur me Kishën dhe kam qenë anëtare e korit në kishën “Zoja Ndhimtare” në Prizren, nën udhëheqjen e mons. Nikollë Minit. Kam studiuar në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prizrenit, drejtimi gjuhë dhe letërsi angleze. Pas martesës, në vitin 1987, kam punuar si arsimtare e gjuhës angleze në dy shkolla në komunën e Ferizajt. Pastaj pasoi lindja e tre fëmijëve. Pas dy vite punë, iu kushtova rritjes dhe edukimit të fëmijëve të mi. Familja ku unë u martova kishte tradita Kishtare dhe kombëtare që praktikoheshin si në familjen ku u rrita. Një ndër kuletërit e mi ishte meshtar, më vonë edhe ipeshkëv, pra mons. Lucjan Avgustini, të cilin Hyji e thirri tek vetja, por vazhdon të mbetet krenaria e familjes dhe e gjithë kombit tonë.

Në vitet e 90-të bashkëshorti im u detyrua të emigronte në Zvicër për shkak të situatës së atëhershme politike dhe ekonomike në Kosovë. Në vitin 1992 i bëra një vizitë bashkëshortit tim Gjekës dhe aty takova misionarin e atëhershëm don Aleksander Kolën, i cili sapo kishte filluar punën në Mision. Pastaj në vitin 1995 unë, së bashku me 3 fëmijët tanë erdhëm përfundimisht në Zvicër dhe menjëherë fillova të angazhohem në Misionin Katolik

Shqiptar të Luzernit. Fillimi ishte shumë i vështirë në një vend të huaj, me një gjuhë dhe tradite të re, larg vendlindjes dhe familjes, me fëmijët e vegjël. Me shumë sakrificë dhe përkushtim, fillova të mësoj gjuhën gjermane dhe t'i përshtatem ambientit ku jetoja. Shumë shpejt u përshtata dhe u punësova në shitje, pasi njihja gjuhën angleze, e dy vite pas u punësova në Spitalin e Kantonit të Luzernit, në mirëmbajtje, pasi që orari i punës më përshtatej më shumë. Këtu fillova shkollimin e mëtejshëm. Përfundova edhe një kurs tjetër të gjuhës, kursin për kompjuter, për mediatore, ku punova si Mediatore për gjashtë muaj në Projektin e Caritas-it, krahas punës në Spital. Këtu ndihmoheshin gratë e veja si dhe ato gra që kishin lënë burrat në Kosovë dhe bashkë me fëmijët e tyre, me shumë peripeci e mundime, të traumatizuara kishin emigruar gjatë luftës së Kosovës. Kam marrë pjesë dhe kam qenë antare e bordit në shoqatën për bashkëpunim Shqiptaro-Zviceran “Drini”, para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Së fundi përfundova shkollën për ndihmëse të motrës medicinale (Schule für pflegeassistenten) dhe prej 15 viteve vazhdoj të punoj në një shtëpi të moshuarish (Pflegeheim) ku jam e punësuar akoma edhe sot.

Si ka filluar bashkëpunimi juaj me Misionin Katolik Shqiptar në Luzern?

Bashkëpunimi me Misionin tonë dhe me meshtarët tanë të nderuar don Marjan Markun dhe don Marjan Demën, ka filluar sapo erdhëm në Zvicër. Pastaj me ardhjen e m. Violeta Kola dhe m. Mrika Sabedini formuam korin e Misionit, u zgjedha sekretare e Korit për disa vite. Më vonë u zgjedha si e deleguar e Misionit në Landeskirche për 8 vite. Siç dihet, në fillim qendra e Misionit tonë ishte në Littau, aty filluan hapat e parë të Misionit: këndimi në kor,

besimi me fëmijët dhe kremtimi i festave të ndryshme. Aty njoftuam shumë besimtarë dhe aktivistë të tjerë të Misionit të cilët u benë familja jonë e dytë. Gjatë kohës kur isha e deleguar e Misionit në Landeskirche u realizua edhe dëshira jonë shumëvjeçare, ku ne si bashkësi shqiptare katolike të mund të kishim qendrën tonë, në St. Michael, në Luzern, ku edhe sot kemi zyrat dhe Kishat në të cilat vazhdojmë të kremtojmë Meshën e shenjtë dhe bëjmë aktivitete të ndryshme kulturore dhe shpirtërore.

A mund të na tregoni në pika të shkurtra si është e strukturuar një ditë e juaj?

Në fakt, asnjë ditë e imja nuk është e njëjtë, por një gjë mbetet e pandryshueshme: Çdo ditë e filloj me shenjen e kryqit dhe lutjen e falënderimit ndaj Zotit.

Pastaj, si çdo grua, merrem me punët e përditshme shtëpiake: familja, puna, shtëpia, shoqëria, gatimi, leximi, meditimi etj. Në qendër të të gjitha këtyre gjërave qëndron familja ime, e cila më jep forcë, që edhe ditët e vështira dhe të zymta të kthehen në ditë gëzimi dhe domethënie. Një forcë të madhe më japin sidomos nipat dhe mbesat e mia që i dua shumë!

Sa e lumtur jeni për punën vullnetare që bëni në Mision dhe a do t'i ftonit edhe të tjerët, sidomos të rinjtë që të angazhohen në Misionin tonë?

Jam vërtetë e lumtur me shërbimin tim që bëj në Misionin tonë në Luzern. Ndjem shumë e lumtur kur mundem të ndihmoj të tjerët përmes mbledhjeve në Këshill të Misionit, leximit në liturgji, këndimit në kor, organizimit të festave dhe aktiviteteve të shumta që bëjmë me Forumin e grave të Misionit tonë, e tani edhe përmes ndonjë shkrimi në revistën Misioni ynë. Nuk pres asgjë në këmbim, por, realisht më kthehet në zemër shumë dashuri, gëzim dhe miqësi. Për të gjithë ne që angazhohemi, Misioni është familja jonë e dytë. Prandaj

edhe i ftoj të rinjtë dhe jo vetëm ata, që të mos ngurrojnë të vijnë e të angazhohen në Misionin tonë, sepse jam e bindur se aty do të gjejnë një ambient të këndshëm me një shoqëri të mrekullueshme që dinë të dhurojnë shumë gëzim dhe dashuri.

Çfarë ju bënë të lumtur e çfarë jo në lidhje me jetën që të rinjtë bëjnë sot?

Më bënë vërtetë të lumtur kur e shoh rininë tonë që flasin gjuhën shqipe, shkollohen dhe arrijnë të integrohen mirë. Tashmë kemi mjekë, avokatë, inxhinierë, arkitektë, ekonomistë, udhëheqës të suksesshëm të firmave, sportistë etj. Gëzohem kur ata nuk i harrojnë traditat tona të mira shqiptare, kur ata mbetën të shëndoshë, kur i shoh në Kishë dhe të angazhuar në shërbime. Nuk do të më bënte të lumtur ikja e tyre nga këto vlera.

Cili është mesazhi i juaj për lexuesit e revistës sonë?

Dëshiroj të ritheksoj se Misioni Katolik Shqiptar në Zvicër, në krye me të gjithë Misionarët që e kanë udhëhequr, është shembulli më i mirë dhe më konkret se si në një vend të huaj është e mundur të ruhet identiteti kombëtar, gjuha dhe tradita, dhe njëkohësisht të bëhet integrimi në vendin ekzistues. Kështu që uroj të punojmë në këto të dy drejtime: Të ruajmë vlerat tonë të mira e të shenjta kombëtare, shpirtërore dhe familjare, dhe njëkohësisht të jemi të integruar në shoqërinë ku jetojmë dhe punojmë. Shembulli konkret, për ne shqiptarët, janë vëllezërit tanë arbëreshë në Itali.

Zonja Avgustini, ju falënderojmë përzemërsisht për intervistën dhe kohën që ndatë për lexuesit tanë.

Faleminderit juve dhe shumë suksese!

Intervisoti: Mirlinda Dushi Berisha, Ettiswil



NËNA SHQIPTARE E DASHURISË

Në historinë njerëzore ka filozofë që kanë dhënë mendime të tejkoshme për njeriun dhe ekzistencën e tij, shkencëtarë që kanë bërë zbulime marramendëse dhe kanë përcaktuar drejtimet e zhvillimit në Tokë, artistë që kanë krijuar vepra mahnitëse e të pavdekshme, shkrimtarë kolosalë që kanë ditur në mënyrë mjeshtërore të hulumtojnë ekzistencën njerëzore dhe të shkruajnë për bukurinë apo pikëllimin e jetës, heronj e udhëheqës titanë që kanë zhvilluar betejat të mëdha politike e ushtarake.

Njerëzimi njih Platonin e Aristotelin, Homerin e Virgjilin, Danten e Shekspirin, Gëten e Balzakun, Dosjtojevskin e Muxartin, një edhe shumë e shumë të tjerë që me veprat mahnitëse e kanë bërë botën më të bukur, më të qartë dhe më të kuptueshme.

Por vështirë është të gjesh një rast të dytë në botë - që një njeri, një grua - po Një Grua të ketë përvetësuar zemrën e njerëzimit dhe të jetë pagëzuar me emrin më të ëmbël: nënë.

Kjo është Nëna Tereze, unike, e cila, ashtu siç pohon shkrimtari Visar Zhiti siç dukej për së dyti Krishtin në tokë. Po - siç shkruan Zhiti "siç dukej Zoti ndjeu nevojën e përsëdytjes së Krishtit mbi tokë, na pëlqen të mendojmë dhe zgjodhi një grua për barazi."

Po, Gonxhja e re që thotë një lamtumirë të pikëlluar nënës Drane në Shkup, përmes dallgëve të forta të jetës, në shekullin e trazimeve

të forta ideologjike, të luftërave e të përplasjeve të pamëshirshme, në shekullin e egërsisë, kthehet në Nënë për të gjithë njerëzimin; nënë për të gjitha kombet, gjuhët, fetë dhe shtresat shoqërore.

Nëna e dashurisë - e vlerësuar kështu nga Don Lush Gjergji, biografi më i shquar i saj dhe autori më meritues që ka bërë që sot ajo të jetë e njohur botërisht si shqiptare, Gonxhja e Prizrenit, Shkupit e Gjakovës, Shkodrës – gruaja e imtë e me zemër të madhe - përgjatë jetës së saj tokësore e ndërtoi një perandori të pafund të dashurisë për njeriun, ku i bëri të papërfillshëm kufijtë, dallimet.

Dhe sot ajo për popullin shqiptar është engjëlli rojës dhe njëra prej vlerave me sublime, që tashmë është gdhendur në historinë tonë kombëtare dhe në atë universale.

Duke u lutur, duke vepruar dhe duke e parë në secilën qenie njerëzore Jezusin, Nëna Tereze la testamentin madhështor të dashurisë; na mësoi ta duam jetën, ashtu siç është, plotësisht, pa pretendime, siç bëri ajo përditë, me njerëz të urit, të braktisur, të lënë, dhe me ta krijoi një simfoni të shpresës, një himn të dashurisë dhe të solidaritetit njerëzor.

Dhe vërtetë dukej sikur bota kishte uri për gjëra të tilla e për një Grua të tillë, për një shkollë të tillë, për një mësim të tillë, për "përsëdytjen" e Krishtit dhe mishërimin e tij në një grua, për t'i treguar botës se dashuria është

vlera më sublimë që kemi dhe se me të mund ta ndryshojmë botën për të mirë, mund t'i zbusim dhimbjet dhe t'i rrisim kufinj të gëzimit.

Nëna shqiptare e dashurisë në faqet e historisë së njerëzimit gdhendi me shkronja të arta emrin shqiptar, duke e pohuar vetë, me rastin e marrjes së Çmimit Nobel për Paqe, kur tha: “Me gjak jam shqiptare”. E këto fjalë tingëljuan si këmbana të paralajmërimit të një përlindje e të një meshe të madhe të dashurisë.

Ajo ka treguar me vepra paqe dhe dashurie se drita përherë e mund errësirën, ashtu si kurse e mira e mund të keqen.

Ajo e ka kuruar të keqen vetëm me dashuri dhe dhembshuri, prandaj sot është personaliteti më shembullor i kohës sonë, nënë dhe shenjte e dashurisë dhe humanizmit.

Gonxhja jonë është lule e bukur në kopshtin tonë kombëtar dhe shtylla më fisnike e më sublimë e identitetit tonë kombëtar, një gurrë frymëzimi për të sotmen e të nesërmen.

Shkolla e saj është dritëdhënëse dhe një trashëgimi e pasur dashurie që ka kapacitete të pafund për t'i kuruar plagët e njerëzimit dhe të kombit tonë, ato plagë të së kaluarës, të mosdurimit, përbuzjes së tjetrit, urrejtjes e ndarjes.

E neve - si pak kujt - na takon të bëhemi nxënës të kësaj shkolle, ta shuajmë etjen në këtë “krua” të gjallë e të marrim energji për të mirën tonë dhe të njerëzimit.

Këshillat e saj të thjeshta dhe shumë domethënëse, janë thesare ushqyese për zemrën e mendjen njeriut, çdo herë dhe në çdo kohë, sepse burojnë nga një zemër e madhe e me përvoja të forta, që pati vend për të gjitha dhimbjet dhe gëzimet e botës.

Ja një prej tyre: “Mos më thuaj se në botë ka luftë. Mos më thuaj se njerëzit veniten nga uria. Mos më thuaj se njerëzit vriten nga urrejtja. Mos më thuaj se njerëzit gërgasin dhe përndjekin njëri-tjetrin, por vetëm më thuaj: Ç'bën ti?”

Nëna Tereze si vajzë e re, ndjeu thirrjen dhe



(Foto: Nue Tuqi)

lejoi të udhëhiqej nga një yll qiellor, njëlloj si ata dijetarët në tregimet biblike dhe shkoi për ta takuar Krishtin, jo në Bethlehem, në katedrale, por në Kalkutë; tek të varfërit, e prej aty, kudo në botë. Dhe rrugëtimi i saj s'u ndal kurrë.

Më urti, përkushtim, ajo tundi themelet e një bote të egërsuar dhe egoiste në të cilën dashuria tingëllonte si një nocion abstrakt.

Dhe përditë, me vepra të mëshirës, tregoi se bota mund të drejtohej me dashuri dhe se dashuria ishte e vetmja fuqi që mund të transformonte botën në mënyrë pozitive. Dhe ajo e bëri një gjë të tillë.

Nënë Tereza e ka provuar se “dashuria mund ta shpëtojë botën”.

Nëna Tereze s'ishte vetëm një edukatore, një murgeshë e përkushtuar pas të varfërve, një solidare e jashtëzakonshme e një misionare e Zotit. Ajo ishte edhe një poete, një mendimtare e jashtëzakonshme, e cila i la botës trashëgimi, vargje/uratë që ngërthejnë një filozofi mahnitëse të urtisë dhe magjisë së fjalës. Poezitë e saj si: “Jeta”, “S'ka rëndësi”, “Koha”, etj., janë perla, një shëmbëllim i fuqishëm i artit të madh.

Prandaj, në këtë kohë krizash, është e udhës që në tryezën tonë, ta shtojmë ushqimin që jep shkolla e Nënës Tereze.

Shkruan: Ndue Ukaj, Prishtinë



(MOS) RËNIA NË DËSHPËRIM

Statistikat tregojnë për numrin e madh dhe rritjen e vazhdueshme të personave të prekur nga depresioni. Që në thelbin e saj depresioni ndikon ose prek në paaftësinë e individit për të shijuar jetën. Duke dëmtuar aspektin konjitiv (njohjen apo proceset e njohjes: perceptimin, imagjinatën, memorien dhe të gjitha format e arsyetimit), ku theksohet një mungesë e madhe e të arsyetuarit dhe të shikuarit e gjërave në aspektin pozitiv, vështirësi në të përqendruar si dhe vështirësi me kujtesën. Aspektin emocional që topit ndjenjat dhe bën të pamundur që individit të përjetojë emocione pozitive. Dhe aspektin social ku personi tashmë me një ndjeshmëri shumë të lartë, e ka më të vështirë të ndërveprojë me tjetrin, dhe në të shumtën e rasteve kjo vështirësi e qon drejt një izolimi apo vetmie.

Jeta nuk i aplikon (realizon) gjithmonë planet tona, dhe nuk ecën krah projekteve tona, ajo di edhe ta befasojë njeriun për te keq, jo për inat të tij, por sepse ajo kështu është e përberë. Dhe këto ndryshime që ndodhin në jetën e njeriut, sikurse janë: humbja e një të dashuri, edhe në mënyrë tragjike, tërmetet, sëmundjet e ndryshme, divorcet, mungesa e kuptimit të jetës, liria jonë që na mbush me përgjegjësi, e pastaj shumë herë dhe me ndjenja faji, statusi social: kush jemi brenda kësaj shoqërie, dhe kush është kontributi që dua të jap , apo e jap, mossauesi që e kemi parashikuar në shkollë ose punë, ekonomia etj.

Këto janë situata që njeriun e venë para një ndryshimi të madh, shpeshherë situata që ai i konsideron të pavend dhe të padrejta, dhe si rezultat i kësaj padrejtësie, njeriu mund të ndjehet në kurth nga jeta dhe fillon të humbasë interesimin ndaj saj, duke e refuzuar

atë si të tërë. Të gjitha këto ndjenja boshllëku, zemërimi, mungesa e kuptimit apo e domethënies janë normale të përjetoohen në një afat të shkurtër kohor pas një ngjarje të rëndë që përjeton personi, por rreziku është kur ato zgjasin në kohë dhe ndikojnë në disfunkcionalitetin e njeriut, në përditshmërinë e tij. Humbja e interesit ndaj gjërave që më parë i kanë pëlqyer, humbje e interesit për përfshirje në aktivitete të reja, rënie e disponimit, ndryshimet fizike, irritimi i shtuar, mungesa e oreksit, ndryshimet në gjumë, ndjenja të forta të qenit i pavlerë ose i të qenit fajtor, lodhjet e tepërta, ndjenja e mungesës së shpresës për të ardhmen, janë disa prej simptomave të zakonshme të depresionit, që individit i përjeton për një periudhë 2 deri në 5 javore ose më shumë nga këto simptoma.

Por çfarë na ndihmon për të tejkaluar në mënyrën më të shëndetshme, edhe këto sfida që shembin shumëçka te individit? Cila është ajo forcë, ai besim, ajo aftësi përballimi për të tejkaluar këtë gjendje, e për të fituar serish kënaqësi nga jeta?

Secili person është unik, duke përjetuar dhimbjen në mënyrë krejt të veçantë nga të tjerët, por secili ka mënyrën e tij të përballimit edhe në procesin e rimëkëmbjes, marrjes së vetes pas një fatkeqësie. Krahas kësaj ka disa mënyra të përgjithshme ndihmuese për të dalë nga zymtësia e dëshpërimit. Njeriu bën përpjekje për t'u shkëputur nga gjendja shpirtërore që është trishtimi. Edhe pse duhet kuptuar që nuk është e thënë që të gjitha format e trishtimit duhet të hidhen me patjetër larg nesh, sepse edhe trishtimi apo melankolia, dhimbja, mërzia, si manifestim i trishtimit, kanë anët e tyre pozitive, duke na shuar interesin për çdo

lloj veprimtarie argëtuese dhe duke na e përqendruar vëmendjen te humbja. Trishtimi na shkëput për pak kohë nga jeta e vrullshme duke na dhënë mundësinë të mbajmë zi për humbjen, të meditojmë për domethënien e saj dhe të gjejmë forcën në vetvete për të vazhduar përpara. E në këtë mes një faktor shumë i rëndësishëm është koha, koha për të reflektuar mbi atë çfarë ka ndodhur, koha për të përjetuar me vetveten atë çfarë ka ndodhur, koha si një faktor për të marrë forca të reja për t'u rilidhur me jetën. Por koha si ngecje në të kaluarën, duke na bërë të vështirë të shohim të ardhmen, dhe për më shumë duke mos e konsideruar kohën e së ardhmes, nuk është një kohë ndihmuese dhe kohë që shëron. Koha që na shteron gëzimin, që na udhëheq drejt depresionit të renduar, duke mbjellë një urrejtje apo përbuzje për veten dhe për jetën, nuk është kohë që shëron.

Një faktor tjetër ndihmues është shoqërimi. Të gjithëve na pëlqen vetmia kur ndihemi të mërzhitur, megjithatë, në shumicën e rasteve ajo vetëm sa e thellon trishtimin duke na bërë të ndihemi të braktisur. Pra një prej mënyrave më të mira për ta luftuar depresionin është shoqërimi me njerëz. Mund të dalim për darkë ose për një drekë, mund të shkojmë të shohim një film apo një ndeshje sportive.

Po ashtu një strategji tjetër është të mësojmë t'i kundërshtojmë mendimet dhe idetë që na bëjnë të mbyllemi në vetvete duke vënë në dyshim vërtetësinë e tyre dhe duke u përpjekur të gjejmë rrugëzgjidhje të tjera më pozitive.

Një mënyrë tjetër e përshtatshme për t'u ndjerë më mirë është edhe arritja e fitoreve të vogla por simbolike. Një e tillë mund të ishte pastrimi apo ndonjë punë që kemi dashur të bëjmë nëpër shtëpi. Edhe përmirësimi i paraqitjes sonë të jashtme, qoftë edhe duke bërë një dush, duke u rregulluar dhe duke veshur rroba të hijshme, mund të na bëjnë të ndihemi më mirë. Por edhe aktivitetet apo ushtrimet fizike në përgjithësi, sepse përmes tyre na jepet mundësia të ndryshojmë regjimin e punës së trurit në mënyrë që të mos përputhet me gjendjen emocionale që duam ta shmanjëm.

Një tjetër mënyrë e shkëlqyer është duke i ndihmuar të tjerët në nevojë. Duke u përfshirë në punë vullnetare, si për shembull duke ndihmuar të rinjtë me këshilla apo duke shpërndarë ushqim për të pastrehët etj, studimet kanë treguar se kjo është një formë e fuqishme për të përmirësuar gjendjen shpirtërore.

Dhe së fundmi një mënyrë tjetër, e cila ndihmon në luftimin e depresionit është shpresa, që sipas disa psikologëve është shumë më shumë sesa një ngushëllim i lehtë në qaste të vështira. Mark Snyder, një psikolog social e përkufizon shpresën si “të besuarit që zotërojmë vullnetin dhe aftësinë për të arritur synimet tona, cilado qofshin ato”. Sipas tij njerëzit me nivele të larta shprese dinë ta motivojnë veten për të ecur përpara dhe janë në gjendje të gjejnë vazhdimisht rrugë të reja për t'i kapërcyer vështirësitë. Pra si përfundim, njerëzit që shpresojnë kanë shumë më pak gjasa të prekën nga dëshpërimi, sepse ata kërkojnë vazhdimisht rrugë të reja për të arritur qëllimet e tyre. Në përgjithësi ata ndiejnë më pak ankth dhe emocione negative.

Të parët tanë dhe dëshpërimi

Të parët tanë, prindërit tanë pavarësisht shumë vështirësive, i kemi parë se e kanë bekuar jetën, e kanë dashur atë duke mos e etiketuar si një shëmti që ju ka rënë përmbys, si një gjë e pakuptimtë, si një gjë pa pikën e domethënies, ata s'kanë lejuar që koncepti për botën të jetë i ndërtuar në këto besime, besime që transmetohen pastaj përmes një gjuhe shkurajuese, por ata vepruan ndryshe: e bekonin jetën duke u dhuruar, duke qenë falënderues për ekzistencën si dhe bekues ndaj ekzistencës.

Ata jo që se kuptonin jetën, për çfarë perspektiva jonë aktuale e zyrtë edhe i paragjykon me raste, por, ata e kuptonin aq mirë e aq shumë sa që e dinin që më më rëndësi se të kuptohet jeta, më e domosdoshme është ta jetosh atë e ta pranosh si të tërë. Kjo ishte forca e tyre, e kjo duhet të jetë edhe forca jonë e re, për të cilën kemi nevojë: të dhurohem tani, pa pritur për të nesërmen, sepse po të rrimë e të presim, ndoshta s'do të kemi një rast tjetër. Dhe ta bekojmë jetën, sepse kështu shfaqim mahnitjen ndaj saj, shfaqim dhe njëkohësisht transmetojmë edhe tek të tjerët emocione të këndshme dhe pozitive (reale) për të, dhe kështu do të dëshmonim besimin praktik. Sepse kush beson në praktikë, edhe vuajta për të është një sfidë dhe jo një fakt i përhershëm. Pra ai që beson në jetën, në të mirën, në të bukurën, por edhe në Zotin, në praktikë është ai që e bekon jetën, sikur kanë vepruar prindërit tanë, dhe për të tillët është më e vështirë rënia në dëshpërim!

Shkruan: Daniel David Ukaj, psikolog klinik



(Foto: nga Arkivi)

GJAK NË SHKODËR

Me të vërtet, o Zot, ke qenë këtu, me ne, dhe na ke kërkuar ta marrim në trupin tonë mëkatin e vëllezërve.

“Na kanë rrahur, na kanë vënë vezë të ziera nën sjetulla e kështu na kanë lidhur deri në djegien e kockave; na kanë lënë lakuriq për muaj të tërë; e lakuriq, të lidhur në pemët e kopshtit të kuvendit, në dimrin tonë plot acar.

Për ditë e ditë i kanë mbajtur të palëvizura bijat tona të lidhura te parmakët. Dhe natën i kanë mbajtur të varura për duarsh.

Kanë shkarkuar shumë e shumë korrent në veshët tanë dhe shumë prej nesh kemi vdekur kështu.

Kanë ngulur në mes kofshëve tona majat përvëluese të pushkëve; i kanë zhveshur në publik meshtarët tanë, e kanë mbyllur në një thes një bijën tonë të zhveshur, së bashku me një mace të tërbuar e pastaj e kanë rrahur e

rrahur. Derisa gjithçka është bërë copë e vetme gjaku të mpiksuar.

Na kanë mbajtur për ditë e ditë të mbledhur në banjën e qelbur të nënshkallës, në torturë fizike morale. Për të fjetur na kanë grumbulluar në një copë çimento prej vetëm tridhjetë e nëntë Centimetrash; i kanë lagur vazhdimisht qelitë tona të izolimit, që të mos mund të shtriheshim; e kanë bërë copë copë mishin e kofshëve tona dhe i kanë mbushur plagët me kripë; i kanë vënë bijat tona në të njëjtën qeli me meshkuj dhe një vajzë në të njëjtën qeli të një frati.

E kanë shkatërruar Marinë, duke e lënë të dekompozohet nga agjërimi mes zheleve të lagura posaçërisht: një vajzë e dashur, njëzet e gjashtë vjeçare!

I kanë thyer dhëmbët tanë me shkelma e me grushte; i kanë thërrmuar gishtat tanë de-

risa thonjtë tanë të nxirë të binin me dhimbje: kanë bërë të vlonin parazitë në trupin tonë: ple-shtat, çimkat e morrat: sa shumë!

Pastaj kanë dezinfektuar ambientet duke na mbuluar me insekticide për tri ditë.

Na kanë varur për këmbësh si bagëti të ther-ura.

Shqipëri e përgjakur!

Jemi kalbur në kanalet që kemi ndërtuar si të dënuar me punë të detyruar, e shumë e shumë prej nesh kemi vdekur në baltë.

I kanë gërmuar fytyrat tona dhe trupat tanë nuk ka më bukuri e as fuqi në ne.

Si krimba, dhe jo si njerëz, vlonim mes mi-neraleve, nën tokë...

Na kanë detyruar të jemi të pabesë; na kanë detyruar të bëhemi spiunë për vëllezërit; u kanë rrëmbyer fëmijëve tanë çfarëdo shenjë Feje që të mund të na burgosnin; nën tortura na kanë urdhëruar të dëshmojmë në rrenë e të tradh-tojmë vëllezërit...

Na i kanë hequr edhe lotët për vëllezërit tanë që i kanë vrarë, përndryshe na priste burgu.

Na kanë vjedhur krijimtarinë, nismën, kul-turën; vetë priftërinjtë tanë kanë mbetur të zbrazët, çuditërisht të varfër....

Fatlumët mes nesh kanë mundur të bër-tasin "Rroftë Krishti Mbret!" para togës së ek-zekutimit, pas murit të varrezave katolike, e tani atje gjendet cynari që dëshmon, sepse gro-pat tona nuk i kanë bërë të thella: qentë kanë ardhur të gërryejnë mbi kufomat tona, pesëm-bëdhjetë vjet më vonë, gëlqerja e gjallë digjej, digjej....

Shqipëri e përgjakur...!

Por Fenë tonë, jo nuk kanë mundur ta pre-kin! Dhe kanë mbetur si pishtarë, në eklipsin e arsyes, të humanizmit, të vlerave, ku të gjitha të tjerat janë shkatërruar.

Po të kishin mundur, do t'i kishin çrrënjosur edhe shpirtat tanë! Po këtë, jo, nuk kanë mun-

dur ta bëjnë.

Ne ta kemi besuar Ty, o Zot, atë që ka mbe-tur prej shpirtave tanë, Ty ta kemi besuar atë që ka mbetur prej trupave tanë; dhe secili prej nesh tani pret prej teje që të lulëzojë në trup të lavdishëm.

O Zot, bëj që të mos jetë urrejtja tani ajo që e bën të kotë Fenë tonë.

Mos lejo që tani të vdesin shpirtat tanë...

Me të vërtet, o Zot, ke qenë këtu me ne, dhe na ke kërkuar të marrim në trupin tonë mëkatin e vëllezërve."

Letër e shkruar nga: Atë Giuseppe Patti, SI Shkodër, Shqipëri, 6 korrik 1993



(Foto: nga Arkivi)



SHËN PIU NGA PIETRELÇINA

(Foto: Pixabay)

Bota ka nevojë si për bukën, për mëshirën e Zotit, atë mëshirë, së cilës Atë Piu nga Pietrelçina i shërbeu aq, sa të bëhej për miliona njerëz, përkëdhelje e gjallë e Atit Hyjnor.

Më 23 shtator kalendari kishtar ka përkujtuar festën liturgjike të Shën Piut nga Pietrelçina, meshtar rregulltar kapuçin.

Shën Piu lindi më 25 maj 1881 në Pietralçinë, në provincë të Beneventos. Vetëm 16 vjeç, hyri në kuvendin e Etërve rregulltarë kapuçinë më 22 janar 1903 duke marrë emrin si rregulltar, fra Piu nga Pietrelçina. Shtatë vjet më vonë shugurohet meshtar, më 10 gusht 1910.

Në vitin 1916 eprorët e transferojnë në San Giovanni Rotondo, mbi Garganë, në Puglia, e këtu në kuvendin e Shën Marisë së Hireve, nis historia e tij prej traumaturgu e apostulli të Sakramentit të Rrëfimit. Më 20 shtator 1918 Atë Piu kapuçin fiton varrët e Mundimeve të Jezu

Krishtit që do të mbesin të hapura, me dhimbje e gjakderdhje për 50 vjet më radhë. Ndërroi jetë më 23 shtator 1968, në moshën 81-vjeçre. U shpall i Lum më 1999; shenjt, më 16 qershor 2002 nga Papa Gjon Pali II.

Shën Piu nga Pietrelçina, meshtar i Urdhrit të Fretërve të Vegjël Kapuçinë, u angazhua shumë në udhëheqjen shpirtërore të besimtarëve e në pajtimin e mëkatarëve me Zotin nëpërmjet Sakramentit të Rrëfimit. Pati një kujdes të posaçëm ndaj nevojtarëve e të varfërve, për të cilët dhuroi gjithçka e ndërtoi edhe një shtëpi-spital “Lehtësimi i vuajtjeve”. Shtegtimi i tij tokësor qe plotësisht në shëmbëllim të Krishtit të kryqëzuar.

Duke përshkruar figurën e Shën Piut, duhet të nënvizojmë dy aspekte themelore të fratit nga Pietralçina: besnikërinë e tij ndaj Ungjillit dhe orientimin e vazhdueshëm drejt mbretërisë së qiellit. At Piu, që vazhdon të jetojë në misterin e Jezusit të vdekur e të ngjallur, ishte dishe-

pull i Krishtit që nuk deshi tjetër veçse të donte e të vuante për Të. Ishte meshtar që nuk kërkoi gjë tjetër veçse të shkrihej nga dashuria për Zotin e për vëllezërit.

Shën Piu ishte bir i sinqertë i Kishës, i cili edhe në rastet më të dhimbshme preferoi të mos mbrohej, duke e mohuar vetveten, i varrosur nën heshtjen e butë të bindjes së mundimshme, por të frytshme.

Me dukjen e plagëve të Krishtit në trupin e tij, At Piu “riprodhonte dukshëm figurën e të Kryqëzuarit” dhe fizikisht, sa herë që jepte Sakramentin e faljes, dëshmonte për çmimin e gjakut të shenjtë, që i është dashur të paguajë Krishtit për shpëtimin e njerëzimit. Plagët e Krishtit u kujtonin të gjithë atyre, që kërkonin ndërmjetësim e mrekulli përmes Shën Piu, se sa kushtonin ato “hire”, që Zoti shpërndante me bujari e përdëllim.

Thelbi i jetës së At Piu përqendrohej në Meshën e Shenjtë, në kremtimin e përditshëm të Eukaristisë. Frati i Pietrelçinës i këshillonte të gjithë besimtarët e të gjithë njerëzit, t’i afroshin Jezusit, në një takim pa rezerva, siç mund të kuptohet edhe nga një regjistrim i zërit të shenjtit, ku pohonte: “Të duam pa asnjë rezervë, pavarësisht nga shpërblimi, që Zoti ka në mend për ne – ajo është rrjedhojë – duke e bërë tonën moton e Shën Palit Apostull: «S’ di tjetër, përveçse Jezu Krishtin, e këtë, të kryqëzuar».

Marrë nga Radio Vatikani

Lutja e Padre Pio-s

Qëndro me mua, o Zot, sepse kam nevojë për praninë tënde që të të mos harroj Ty. Ti e di sa lehtë mund të të harroj.

Qëndro me mua, O Zot, sepse jam i ligësht dhe më nevojitet fuqia jote që mos të bie në mëkat.

Qëndro me mua, o Zot, sepse Ti je jeta ime dhe pa Ty humbi zjarrin që kam për Ty.

Qëndro me mua, o Zot, sepse Ti je drita ime, dhe pa Ty jam në errësirë.

Qëndro me mua, o Zot, dhe më trego vullnetin tënd.

Qëndro me mua, o Zot, që të dëgjoj zërin Tënd dhe të vijë pas Teje.

Qëndro me mua, o Zot, sepse dua të të dua shumë dhe dua të jem gjithmonë afër Teje.

Qëndro me mua o Zot, nëse dëshiron të të jem besnik.

Qëndro me mua, o Zot, sepse edhe pse shpirti im është i varfër, dua që për ty të ketë vend ngushëllimi, strehë Dashurie.

Qëndro me mua o Jezus sepse dita po shkon në të sosur dhe po bëhet natë, jeta kalon, vdekja dhe gjyqi dhe amshimi po afrohet.

Më duhet ende fuqi që mos të devijoj në këtë rrugë, për këtë kam nevojë për Ty. Është vonë dhe vdekja më është gjithnjë e më afër. Frikësohem nga errësira, tundimet, koha e errët, kryqi, pikëllimit.

Amen!



(Foto: nga Arkivi)

Tetor 2022**02.10.2022**

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Sursee
 18:00 Mesha në Giornico

07.10.2022

19:00 Zoja Rruzare, Mesha në Luzern
 19:30 Provat e **përbashkëta** të Koreve në Luzern

09.10.2022

13:30 Mesha në Emmenbrücke
 17:00 Mesha në Willisau

16.10.2022

10:30 Mesha në Goldau
 13:30 Mesha në Sursee

22.10.2022

JUBILEU I 30-TË VJETORIT TË MISIONIT
 18:00 Akademia në Luzern + Apero më të ftuarit

23.10.2022

JUBILEU I 30-TË VJETORIT TË MISIONIT
 13:30 Mesha në Stadthalle Sursee

30.10.2022

13:30 Mesha në Emmenbrücke

Nëntor 2022**06.11.2022**

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Sursee
 18:00 Mesha në Giornico:

13.11.2022

13:30 Mesha në Luzern
 17:00 Mesha në Willisau

20.11.2022

10:30 Mesha në Goldau
 13:30 Mesha në Sursee

26.11.2022

16:00 Ripërtritje shpirtërore për fëmijët dhe ministrantat në Luzern
 18:00 Festa me Korin në Luzern

27.11.2022

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Luzern
 17:00 Mesha në Menznau

29.11.2022

6:00 Rorate në Luzern

Dhjetor 2022**02.12.2022**

18:30 E premtja I e muajit, Mesha në Luzern
 19:00 Ripërtritje shpirtërore për Korin dhe Lexuesit në Luzern

03.12.2022

18:00 Mesha në Vetroz

04.12.2022

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Sursee
 18:00 Mesha në Giornico

06.12.2022

6:00 Rorate në Luzern
 18:00 Festa e Shën Nikollës në Luzern

08.12.2022

14:00 Mesha në Luzern dhe Festa për fëmijë
 15:00 Turneu i lojërave në Luzern

10.12.2022

16:00 Ripërtritje shpirtërore për të rinjtë në Luzern
 19:00 Darka me Këshilltarët

11.12.2022

13:30 Mesha në Emmenbrücke
17:00 Mesha në Willisau

13.12.2022

6:00 Rorate në Luzern

16.12.2022

18:30 **RRËFIMET** e përbashkëta në Willisau

17.12.2022

17:00 Mësim-feje në Luzern
17:00 **RRËFIMET** e përbashkëta në Luzern

18.12.2022

10:30 Mesha në Goldau
13:30 Mesha në Sursee
16:00 Ripërtritje shpirtërore për gratë

24.12.2022 / KRISHTLINDJA

18:00 Mesha në Gettnau
20:00 Mesha në Emmenbrücke
23:00 Mesha në Inwil ZG

25.12.2022

10:30 Mesha në Goldau
13:30 Mesha në Sursee

26.12.2022 / Festa Familjare

19:00 Mesha në Luzern

28.12.2022

19:00 Festa e Fëmijëve të pafajshëm,
Mesha në Luzern

31.12.2022

19:00 Nata e Vitit Ri, Festa në Luzern



Si vitin e kaluar ashtu edhe këtë vit Misioni ynë ka organizuar shëtitjen për ministrantat tanë, në Evropa Park. Ishte vërtetë një përvojë e bukur dhe shumë e këndshme.

Këtë organizim, Misioni ynë, e bënë njëherë në vit si dhuratë dhe falënderim për fëmijët dhe adoleshentët (ministrantat) që çdo të diele i shërbejnë meshtarit në Meshën e shenjtë.

Në përcjellje të fëmijëve ishim edhe ne prin-

dërit, ku patëm mundësi të njihemi më mirë edhe me prindër tjerë dhe kështu bashkërisht përjetuam një ditë ndryshe, të këndshme dhe shumë relaksuese.

Edhe pse udhëtimin e filluam me reshje shiu, falë Zotit dhe dëshirës së fëmijëve, me të arritur në Evropa Park, e deri në momentin e kthimit për në Luzern, kemi pasur një kohë shumë të mirë.

Shkruan: Gjonita Lleshdedaj, Kriens

AKADEMIA SHKENCORE

22 tetor 2022, ora 18:00
në Rodteggstrasse 6, 6005 Luzern

PROGRAMI

- **HIMNI SHQIPTAR:**
Afërdita Krasniqi, soliste; Ermira Lefort, piano;
Shpejtim Krasniqi, solist; Bashkim Krasniqi, kitarë
- ❖ **Fjalimet përshëndetëse:**
- **MONS. DODË GJERGJI, ipeshkëv i dioqezës Prizren-Prishtinë, Kosovë**
- **CORNELIO ZGRAGGEN, përfaqësues i Kishës vendore në Luzern**
- **BEAT ZÜSLI, kryetar i Komunës së Luzernit**
- **PIKË MUZIKORE: “Moj e bukura Arbëri”**
- ❖ **Sesioni shkencor:**
- **MONS. LUSH GJERGJI, biograf i Nënë Terezës**
“Të nxitur nga Nënë Tereza për vepra dashurie - bamirësie”.
Me rastin e 25 vjetorit të kalimit të saj në Amshim.
- **ÇUN LAJÇI, aktor nga Kosova**
- **YLFETE FANAJ, këshilltare e Kantonit të Luzernit dhe e emëruar për**
kandidate në Këshillin Qeveritar
“Integrimi dhe kontributi i shqiptarëve në shoqërinë helvetike”.
- **PIKË MUZIKORE: “Shqipëri o vendi im”**
- **DON DAVID XHUXHA, përgjegjës i Radio Vatikanit në gjuhën shqipe**
“Do të jeni dëshmitarët e mi” (Vap 1, 8) Misionar në shembullin e
Bariut të mirë.
- **PIKË MUZIKORE: “Kur jemi bashkë ne të dy”**
- ❖ **Përmbyllja dhe falënderimi:**
- **DR. DON ANTON UKA, udhëheqës i Misionit Katolik Shqiptar në Luzern**
- **PIKË MUZIKORE, “Rrjedh në këngë e ligjërime”**
- **APERRO**
për të gjithë të pranishmit

MESHA E SHENJTË DHE PROGRAMI ARTISTIK

23 tetor 2022, ora 13:30
në Festhalle Sursee, 6210 Sursee

PROGRAMI

❖ Kremtimi liturgjik:

- **MESHA E SHENJTË**
Kremtues: Mons. Dodë Gjergji, ipeshkëv i dioqezës Prizren-Prishtinë, Kosovë
në bashkë-kremtim me ipeshkvij të tjerë dhe me meshtarët pjesëmarrës në festë

❖ Programi kulturor & artistik:

- **VALLËZIM**
nga fëmijët e Misionit
- **SHKURTE FEJZA**
nën përcjelljen instrumentale të Gëzim Demaj
- **ÇUN LAJÇI**
“Vargje nga Gjergj Fisha”
- **KËNGË DHE VALLE**
Ansambli “Arbëresha” nga Misioni Katolik Shqiptar në Sirmach
- **KRISTË LLESHI**
“Këngë për Nënë Terezën”
- **SHKURTE FEJZA**
nën përcjelljen instrumentale të Gëzim Demaj
- ❖ **Bashkëndarje vëllazërore:**
- **APERO**
për të gjithë të pranishmit

**AZB 6005 Luzern
Post CH AG**
Erscheint 4 x jährlich

Redaktionsschluss:
Nr. 4/2022
15. Dez. 2022

Erscheint im
Dezember 2022

Impressum
Misioni Katolik Shqiptar në Luzern
Katholische Albanische Mission in Luzern

Verlag und Redaktion
Dr. Don Anton Uka, Përgjegjës
Rodteggstrasse 6
CH-6005 Luzern
Tel: +41 41 250 52 60
Fax: +41 41 250 52 67
Cel: +41 79 371 68 91
E-Mail: ukas_cr@hotmail.com
anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch
Mitteilungsblatt für die Mitglieder des Vereins
der Katholischen Albanischen Mission in Luzern.

In memoriam të Marjan Gojanit (1963-2022)

Pas një sëmundje të rëndë, në moshën 58 vjeçare, ka ndërruar jetë besimtari i Misionit tonë Marjan Gojani, nga Velezha e Prizrenit. Marjani njihej në Misionin tonë si besimtarë i mirë, i dashur dhe shumë i respektuar. Këto virtyte e karakterizonin jetën e tij edhe në familje, në punë dhe në shoqëri, kjo u theksua edhe nga vajza e tij, Martina, në fjalinë e rastit që u lexua në përfundim të Meshës së varrimit.

Marjani, disa ditë para vdekjes, ka pranuar sakramentet e shenjta dhe kështu është përgatitur shpirtërisht për takimin përfundimtar me Zotin.

Mesha e varrimit, në prani të një numri të madh të të pranishmëve, është kremtuar të shtunën, më 27 gusht, në Kishën katolike në Hohenrain të Luzernit. Don Antoni, në predikimin e rastit, përveçse të kujtojë jetën dhe veprën e Marjanit, ai, në mënyrë të veçantë, vuri theksin në porosinë e pjesës së Ungjillit e cila u lexua në atë Meshë të shenjtë e që na ftonte të vejmë besimin tonë në Hyjin e gjithëpush-

tetshëm, i cili në personin e Jezu Krishtit u dëftua Zot i jetës dhe i vdekjes.

Familja Gojani kishte vendosur që gjatë Meshës së varrimit të mblidhej lëmosha dhe shuma e grumbulluar të dedikohej për personat e sëmurë. Kështu që në këtë Meshë të shenjtë u grumbulluan 1610,20 franga.

Pas varrimit, siç është traditë, familja kishte shtruar drekën e dritës për të gjithë të pranishmit, në nder dhe falënderim të jetës dhe veprës së Marjanit.

Ndarja nga një person i dashur, e sidomos nga një familjarë, është shumë e vështirë, por, feja na mëson dhe na dëshmon se vdekja është vetëm një kalim për në jetën e amshua. “Çka syri nuk pa e veshi nuk dëgjoji dhe në zemër të njeriut nuk hyri, atë ua bëri Hyji gati atyre që e duan” (1 Kor 2, 9). Marjani e ka dashur Zotin, prandaj, kjo shpresë na bënë të besojmë se ai tashmë veç gëzon në mbretërinë e Tij.

Shkruan: m. Vida Ademi